

VENDIM
Nr.793, datë 4.6.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA MEMALIAJ-FSHAT, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Memaliaj-Fshat, të qarkut të Gjirokastrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 9 (nëntë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Memaliaj-Fshat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARË PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni qendror: MMPAU Komuna: Memaliaj Fshat										
Nr. rendor	Nr. i pasurisë sipas inventarit	Emri i ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK)	Emri i ngastrës, sipas emërtesës popullore	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues , statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	95	E.K Buz	Ceril	1	Kullote	135	Kullotje	MMPAU	Komuna	
2	97	E.K Dukaj-Luzat	Memaliaj	14	Kullote	154	Kullotje	"	"	
3	98	E.K Qender	Kodra Bofeng	35	Kullote	96	Kullotje	"	"	
4	99	E.K Qender	Vilat	36	Kullote	84	Kullotje	"	"	
5	100	E.K Qender	Gropat	37	Kullote	154	Kullotje	"	"	
6	102	E.K Qender	Shkalla Dames	17	Kullote	88	Kullotje	"	"	
7	103	E.K Qender	Qisha Samata	18	Kullote	130	Kullotje	"	"	
8	104	E.K Qender	Perroi Madh	19	Kullote	87	Kullotje	"	"	
9	105	E.K Qender	Shembi Kallemb	34	Kullote	95	Kullotje	"	"	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Memaliaj Fshat

Lidhja nr.1

Numrat e pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
95	Kullotë	Në pronësi
97-100	Kullotë	Në pronësi
102-105	Kullotë	Në pronësi